



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm për Ekonomi dhe Financë

Nr 4042/

Prot



Fushe-Arrez, me 24.12.2025

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 40 datë 12/12/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për “Për miratimin e Planit të Aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Fushë Arrëz për vitin 2026”

Analiza ligjore: Mbështetur në ligjin 139/2015, dt. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak", Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz me propozim të Kryetarit të Këshillit.

Situata aktuale e funksionit dhe Situata financiare :

Këshilli Bashkiak Fushë Arrëz BUXHETI VJETOR 2026

Nr	Emërtimi i shpenzimeve	Numri	Paga dhe sigurime mujore	Lekë në vit
1	Shpërblimi për këshilltarët (1/10 e pages se kryetarit)	15	24000	4,320,000
2	Kryepieqtë e fshatrave	28	12000	5,040,000
3	Sekretari i keshillit, page, sigurime shoqerore	1	107000	1,284,000
4	Sekretariati i keshillit, page, sigurime shoqerore	1	188000	2,256,000
5	Shpenzime për konsultime (detajuar nga plani vjetor i konsultimeve)			66,000
6	Fond për pritje e përcjellje të Këshillit Bashkiak			20,000
7	Dërgim me poste i dokumeneteve, shkresave te këshillit dhe këshilltarëve			12,000
8	Kancelari për zyre			64,000
9	Mirëmbajtje pajisje kompjuterike dhe salla e keshillit			

10	Trajnim per anetaret e keshillit bashkiak ne bashkepunim me projekti Bashki te forta dhe fushate komunikimi me qytetarët			30,000
11	Vizitë studimore, Aleanca e Grave Keshilltare			300,000
12	Ekspertizë për çështje të ndryshme			30,000
TOTALI I SHPENZIMEVE				13,422,000

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Sekretari i keshillit ka relatuar përpara komisionit për Projekt vendimin.

Monitorimi dhe raportimi : Këshilltarët do të monitorojnë vendimit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë e Finances ose Sekretarin e keshillit për zbatimin e tij.

Impakti social / grupet që preken: Projekt vendimi impakton punen e Keshillit Bashkiak dhe indirect jetën të gjitha shtresave, kategorive dhe zhvillimin e të gjithë territorit të bashkise.

Komisioni i Përhershëm për “ Ekonomi dhe Financë”, i mbledhur me datën 24/12/2025, shqyrtoi projekt vendimit nr. 40 datë 12/12/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për “Për miratimin e Planit të Aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Fushë Arrëz për vitin 2026” paraqitur nga Kryetari i Keshillit Bashkiak.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,
Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T’i propozojë Këshillit Bashkiak:

- kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- miratimin e projektaktit

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës** i paraqitur në
proçesverbalin e mbledhjes së Komisionit

Franc Doda Kryetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Besiana Marica Sekretar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA FUSHE-ARREZ

KESHILLI BASHKIAK

**KOMISIONI I EKONOMISE FINANCE BUXHETIT MBIKQYRJES FINANCIARE
PLANIFIKIMIT TE ZHVILLIMIT STRATEGJIK**

Nr. 4042 Prot.

Fushe-Arrez, me 24.12. 2024

PER : KESHILLIN E BASHKISE

FUSHE-ARREZ

**Relacion i Komisionit te Ekonomise Finance Buxhetit Mbikqyrjes Financiare
Planifikimit te Zhvillimit Strategjik mbi shqyrtimin e projektvendimit per
MIRATIMIN E PLANIT TË AKTIVITETEVE TE KËSHILLIT BASHKIAK FUSHË-
ARRËZ PËR VITIN 2026**

Ne zbatim te ligjit 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore", i ndryshuar, u mbledh Komisioni i Ekonomise Finances Buxhetit dhe Mbikqyrjes Financiare sot, me 24.12.2025 per shqyrtimin e projektvendimit mbi miratimin e Planit të aktiviteteve te Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz për vitin 2026. Gjithashtu e pranishme ishte, Sekretarja e Keshillit Bashkiak, znj. Naze Selimaj e cila dha shpjegime per projektin qe do te shqyrtohet ne kete mbledhje dhe se anëtarët e Komisionit janë njohur përmes materialit shkresor i cili gjendet edhe në faqen zyrtare web.

Projekt vendimi per Planin e aktiviteteve, planin e konsultimeve dhe buxhetin e keshillit bashkiak u hartua ne bashkepunim mes, Kryetarit te Keshillit Z.Nikolin Bardhoku dhe Zyres se Finances. Sekretarja e Keshillit dha shpjegimet per kete projekt perpara Komisionit te Ekonomise, Financave, Buxhetit, Mbikqyrjes Financiare, Planifikimit te Zhvillimit Strategjik te Bashkise ku tha se jane te detajuara me tabela, si plani aktiviteteve ashtu dhe buxheti i keshillit.

Zj. Naze Selimaj tha se plani i aktiviteteve eshte i shpjeguar me tabele, ku jane te listuara aktivitete zyrtare te çdo muaji te Keshillit Bashkiak per vitin 2025. Gjithashtu shtoi se bashkelidhur eshte edhe tabela me konsultimet publike me tema te ndryshme, te paracaktuara te zhvillohen gjate muajve Shkurt, Prill, Maj, Gusht, Shtator, Tetor dhe Nentor, por qe mund te ndryshojne ne varesi te projektvendimeve te paraqitura nga Bashkia, si shpenzimet vjetore te ketyre konsultimeve, ku shuma totale e shpenzimeve eshte 66.000 (gjashtedhejete e gjashte) mije leke te vjetra, ku perfshihen ; karburant, qera salle dhe kancelari.

Gjithashtu ajo shtoi se Keshilli Bashkiak ka nje buxhet qe edhe ai eshte i paraqitur me tabelen e faqes se fundit te projektit ku jane te perfshira paga dhe sigurime shoqerore, vizita studimore, kancelari per zyre, trajnime per anetaret e keshillit, shpenzime per konsultime, mirembajtje dhe blerje mjetesh pune, nje kompjuter, etj.

Znj.Naze Selimaj i falenderoi anetaret e komisionit per vemendjen qe i dhane projektit te paraqitur nga zyra e Keshillit Bashkiak Fushe-Arrez dhe i ftoi per pyetje dhe diskutime rreth

ketij projekti. Anetaret e Komisionit u shprehen se nuk kishin asnje pyetje, kundërshtim apo diskutim, mbi këtë projekt, por ishin falënderues për punën që bënte zyra e Sekretariatit të Këshillit gjatë gjithë vitit dhe vendosën me shumicë votash, duke e dërguar projektin për shqyrtim të metejshëm dhe miratim në mbledhjen plenare të muajit, datë 26.12.2025.

PER KOMISIONIN

FRANC DODA



Ben'ana Marku


Zef Lure
Juu!

Valentino. Lleshaj
